

Prishtinë, 30/10/2006
Kodi i ZRRE: D_20_2006

Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

Duke marrë parasysh:

1. Dispozitat e Nenit 15 të Ligjit Nr. 2004/9 “mbi Rregullatorin e Energjisë”;
2. Dispozitat e Nenit 33 dhe Nenit 35 të Ligjit Nr. 2004/10 “mbi Energjinë Elektrike”;
3. Dispozitat e Nenit 20.1 dhe Nenit 22 të Rregullit mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji;
4. Marrëveshjen e propozuar midis divizionit të furnizimit dhe shpërndarjes në KEK, dorëzuar nga Zyra e Çështjeve Rregullative të KEK SHA, në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (“ZRRE”), më 27 shtator 2006;
5. Takimin e përbashkët: ZRRE - Divizioni i Furnizimit & Shpërndarjes /KEK më 28 shtator 2006; janë diskutuar procedurat e përkohshme për leximin e njehsorëve dhe faturimin e konsumatorëve me maksigrafë të instaluar;
6. Procedurat e Përkohshme të rifreskuara të dorëzuar në ZRRE prej Zyrës së Çështjeve Rregullative të KEK-ut më 29 shtator 2006;
7. Komentet përfundimtare të dhëna nga ZRRE-ja më 2 tetor 2006, dhe marrëveshja me KEK-un mbi pranimin e ndryshimeve të propozuara.

Më 30 Tetor 2006 ka vendosur të nxjerrë:

Vendimin mbi aprovimin e Procedurave të Përkohshme për leximin e njehsorëve dhe faturimin e konsumatorëve me maksigrafë të instaluar – Dorëzuar nga Divizioni i Furnizimit & Shpërndarjes /KEK

Kapitulli 1

1. Bordi i ZRRE ka shqyrtuar Procedurat e Përkohshme për leximin e njehsorëve dhe faturimin e konsumatorëve me maksigrafë të instaluar, që është dorëzuar nga KEK, dhe ka vendosur ta **APROVOJË**.
2. Vendimi është i vlefshëm deri në aprovimin final të Kodit të Matjes nga ZRRE-ja .
3. KEK do të fillojë zbatimin e këtij vendimi në datën e marrjes së vendimit dhe publikimit të tij në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
4. Ky Vendim do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të KEK-ut.
5. KEK ka të drejtën e paraqitjes së ankimit në ZRRE kundër këtij Vendimi, duke dorëzuar një raport plotësisht të qëndrueshëm, brenda katërmëdhjetë (14) ditësh pune pas njoftimit dhe publikimit të tij në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
6. Ky Vendim dhe Shtojcat e tij i janë paraqitur KEK-ut në versionin origjinal në datën e publikimit të tij në faqen elektronike zyrtare.

Kapitulli 2: Procedurat e Përkohshme për leximin e njehsorëve dhe faturimin e konsumatorëve me maksigrafë të instaluar. Paraqitur nga KEK në ZRRE (bashkangjitur)

Kryesuesi i Bordit të ZRRE-së

Anëtarët e Bordit:
